

MARENGLLEN VERLI**SHKUPI – QENDËR E RËNDËSISHME SHQIPTARE NË SHEK.
XIX-XX**

Në Fjalorin Enciklopedik (*Kamus'ul alam*) të dijetarit të madh shqiptar Sami Frashëri, një ndër veprat më madhore të kohës, të botuar në gjashtë vëllime, Shkupi vlerësohet si një ndër qytetet shqiptare kryesore në kuadrin e katër vilajeteve, përkatësisht të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, me identitet të qartë etnik. Brenda hapësirës gjeografike Tivar-Mitrovicë-Shkup-Prevezë, Samiu i shquar e gjente popullsinë autoktone shqiptare si një shumicë dërrmuese në një territor kompakt mjaft të përcaktuar.¹ Të njëjtat konsiderata gjenden edhe në shkrimet e disa udhëtarëve e diplomatëve evropianë të shek. XIX, të cilët ofrojnë harta e dokumente etnografike dhe shifra statistikore. Harta e H. Kiepertit (Berlin 1876), etj., cilëson si treva shqiptare, në krahun lindor, të gjithë territorin në perëndim të vijës nga Leskovci në Kumanovë, Shkup e Veles². Të njëjtat konsiderata gjenden edhe në hartën e J.I. Ketberit, botuar në vitin 1920 në Berlin. Sipas studiuesit Roberto Almagias, në një hartë me të dhëna të vitit 1875, (Romë, 1930) trevat shqiptare ndodheshin në perëndim të vijës që kalonte nga Nishi në verilindje të Vranjës e deri në Manastir, duke marrë brenda Preshevën, Kumanovën, Shkupin, Tetovën, Gostivarin e Kërçovën³. Në regjistrimet osmane të shek. XIX, fillimi i shek. XX, madje edhe në regjistrimin zyrtar jugosllav të vitit 1921 (harta linguistike dhe ajo e përkatësisë fetare), përfshijnë në viset etnike shqiptare, Preshevën, Kumanovën, trevën e Shkupit dhe viset deri në afërsi të Velesit⁴.

Georg von Hahn, Ami Boué, Antonio Baldacci, Gabriel Louis Jaray e shumë studiues të tjerë dhe, mbështetur të gjithë në statistikat zyrtare, qofshin ato osmane, austriake ose bullgare, arrijnë në të njëjtin konkluzion: Shkupi në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX ishte qytet

¹ Sami Frashëri, *Kamus'ul alam*, Istanbul: 1891 etj. (vëll. II). Shih zërin *Shkupi*, f. 927.

² Hamit Kokalari, *Kosova, djepi i shqiptarizmit. Në mërgim*, 1962, f. 87.

³ Lumo Skëndo, *Albanais et Slaves*, Lausanne: 1919; Shih dhe H. Kokalari, *Kosova ...*, f. 87.

⁴ H. Kokalari, *Kosova ...*, f. 88.

shqiptar⁵. Me këtë rast citojmë Gabriel Louis Jaray-in, i cili, më 1913 shkruante se “Shkupi është njëherësh një nga kështjellat pararojë të shqiptarëve, si edhe një nga qytetet e tyre me rëndësi ... Shkupi ka afro 45.000 banorë, nga të cilët 25.000 janë myslimanë, pothuajse të gjithë shqiptarë, 10.000 ose 15.000 bullgarë, 3.000 serbë dhe 2.000 hebrenj”⁶. Një dekadë e gjysmë më vonë dijetari gjerman Leonhard Schultz, në librin e tij *Makedonian*, botuar në vitin 1927, duke vlerësuar etnikisht popullsinë rurale të rrethit të Shkupit të vendosur në 82 katunde, konsideron shqiptare 56 katunde, bullgare 14, serbe 9 dhe turke 3 katunde (Gureler ose Konjare e Madhe, Konjare e Vogël dhe Kojlice).⁷

Gjatë shek. XIX Shkupi bënte pjesë te 3-4 qytetet më të mëdha ndër 31 qendrat urbane të trevave shqiptare. I njohur si vendbanim i rëndësishëm qysh në periudhën romake e bizantine, Skupi (Shkupi) kishte qenë qyteti ku më 1345 u kurorëzua Car (perandor) Stefan Dushani. Në shek. XV, ai kishte qenë qendër e rëndësishme osmane, madje, qendër e organizimit të fushatave ushtarake të Perandorisë për pushtimin e Ballkanit⁸. Në mesin e shek. XIX, qyteti numërohej si një qytet i madh jo vetëm në kuadër të viseve shqiptare, por edhe në kuadër të gjithë viseve të Ballkanit Osman. Në vitin 1861 konsulli i Austrisë, Han, shkruante se qyteti i Shkupit kishte mbi 20.000 banorë, përkatësisht 13.000 myslimanë, 7.000 kristianë dhe 800 hebrenj, çka do të thotë se, në këtë kohë, në Shkup popullsia sllave, e cila ishte përgjithësisht e krishterë, zinte më pak se 30% të të gjithë popullsisë⁹. Ndërkohë, shqiptarët përbënin shumicën ndër myslimanët, por që ishin jo të pakët edhe midis të krishterëve, kalonin me sa duket mbi 60% të popullsisë së qytetit. Ndër banorët e Shkupit bie në sy numri jo i vogël i hebrenjve (të cilët ishin të konsiderueshëm në numër edhe në dy qendra të tjera të vilajeteve të njohura si vilajete shqiptare, ku kishte një gjallëri

⁵ *Po aty*, f. 89; H. Kokalari citon secilin nga autorët e sipërpërmendur.

⁶ Gabriel Louis Jaray, *L'Albanie inconnue*, Paris: 1913, f. XIV dhe 9.

⁷ Leonhard Schultz, *Makedonian*, Jena: 1927, f. 157.

⁸ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: “Mihal Duri”, 1984, f. 17; *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë: 1965, vëll.I.

⁹ J.G. Hahn, *Reise durch die gebiete des Drin und Vardar*, Wien: 1867, I, f. 45. Në të njëjtën periudhë saktësisht në vitin 1838, Manastiri kishte 24.000 banorë, nga të cilët 9200 shqiptarë (1200 të krishterë), 9000 sllavë, si edhe turq, hebrenj, vllahë etj. (J. Müller, *Albanian Rumelien und die Osterreichisch-Montenegrinische Granze*, Praga: 1844, f. 85), kurse Janina 25.000 dhe Shkodra 40.000 banorë (Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f. 200).

ekonomike të rëndësishme, përkatësisht në Janinë dhe Manastir), që mendohet se kishin ardhur në këto vise nga Spanja në shek. XV¹⁰.

Duke analizuar përbërjen etnike të popullsisë së Shkupit, por edhe atë të kryeqendrave të tjera të katër vilajeteve shqiptare, konstatohet se në tre ndër katër prej tyre (përfshirë bënte Shkodra), ajo ishte e përzier. Konkretisht në Shkup shumica e popullsisë ishte shqiptare, kurse në Manastir e Janinë shqiptarët ishin popullsia që numerikisht renditej e para, por në të tri rastet ishin dukshëm të pranishme edhe komunitete të tjera etnike¹¹. Është e kuptueshme se në këto qendra vilajetesh, që ishin metropolet urbane të kohës, ku gravitonin popullsitë rurale të periferive, popullsia ishte e përzier. Përbërja etnike e këtyre qyteteve dëshmonte përbërjen etnike të periferive, që, në rastin e Shkupit, atëherë, sikurse edhe sot, në tri anë rrethohej e rrethohet nga vendbanime rurale shqiptare.

Përbërja nacionale kishte përcaktuar edhe shumëllojshmërinë e objekteve të kultit në qytetin e Shkupit. Gjatë shek. XIX aty, përveç objekteve të kultit të fesë islame, kishte edhe objekte të feve të tjera. Madje, në Shkup, kisha ortodokse ishte e organizuar në nivelin e mitropolisë.¹²

Është me rëndësi të theksohet se, nga mesi i shek.XIX, reformat e ndërmarra në Perandorinë Osmane për likuidimin e marrëdhënieve feudale ndihmuan në rritjen e popullsisë dhe ekonomisë qytetare, si edhe në krijimin e lidhjeve të rregullta ekonomike, por edhe politike, kulturore etj., midis krahinave të ndryshme shqiptare, duke krijuar një treg të përbashkët kombëtar. Shkupi, pa dyshim ishte pjesë e këtij tregu, ku rrihte vrullshëm pulsi i jetës shqiptare.¹³

¹⁰ Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f. 37.

¹¹ J. Müller, *Albanien, Rumelien...*, ; Më 1838 për Manastirin shënohej shifra prej 24.000 banorësh nga të cilët 8.000 shqiptarë myslimanë, ku përfshiheshin edhe dy batalionet e garnizonit ushtarak 1200 shqiptarë të krishterë, 9000 sllavë, dhe të tjerët turq, çifutë e vllahë; K. Thesprotu-A.Psalidha, *Geographia Albanias kai Epeiru ex anekdotu*, Janina: 1964, f. 53. Janina vlerësohet se kishte 3000 shtëpi, në fillimet e shek.XX, nga të cilat 1700 greke, 1000 myslimane dhe 300 çifute. Autorët, natyrisht kanë shënuar si greke edhe familjet ortodokse shqiptare. Z.Shkodra, *Qyteti...*, f. 30, duke analizuar të dhëna të ndryshme shënon 12.000 greke, 10.000 myslimane shqiptare dhe 6.000 izraelite, por vëren se duhen vënë në llogari edhe elementë të tjerë shqiptarë që jetonin në Janinë, nëpunësit shtetërorë dhe garnizoni i madh ushtarak i Ali Pashë Tepelenës prej 4-5000 burrash.

¹² Z. Shkodra, *Qyteti...*, f. 37.

¹³ Zija Shkodra, “Çështje të tregut shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare”, *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1978, f. 108.

Në këtë kohë qyteti shquhej për përpunimin e lëkurëve, një nga zejet më të njohura të kohës, e cila mori hov edhe për shkak të rrjedhës së lumit të Vardarit, që kalonte përmes qytetit, nga sigurohej uji i nevojshëm për procesin e regjjes së lëkurëve. Sipas Salnamesë së vilajetit të Manastirit, si edhe njohësve të mirë të trevës, në Shkup tabakët kishin bizneset në vendet e quajtura allaxhe xhivari, afër faltores Medah Xhami, si edhe pranë lumit Vardar ku punoheshin sasi të mëdha lëkurësh.¹⁴ Konsulli francez Viet, më 1864, përmend se në Shkup “ka ... disa tabakhane të pasura, si edhe një pazar të madh”.¹⁵ Sipas Sami Frashërit “mjeshtëria e regjjes së lëkurëve të këtij vendi [Shkupit] motit kish qenë shumë në zë, sa edhe sot aty gjenden disa punishte të tilla”.¹⁶ Sipas G. Hanit ndonëse Shkupi zhvillonte një tregti të gjerë me Shkodrën, prej nga prodhimet e tij të lëkurës eksportoheshin me det në Trieste, e në brendësi të Austrisë, ngarkesat i çonte me karvanë edhe drejt Veriut, përmes Beogradit deri në Hungari. Destinacione të tjera ishin Bosnja dhe Dalmacia.¹⁷ Vetëm nga fundi i shek.XIX, për shkak të konkurrencës së industrisë europiane, zeja e sipërpërmendur hyri në krizë dhe humbi rolin e dikurshëm.¹⁸

Gjatë shek. XIX, Shkupi me rrethinë u shqua dhe për rritjen e krimbit të mëndafshit dhe prodhimin e copave prej mëndafshi, duke u renditur pas Prizrenit në këtë drejtim, dhe duke lënë pas Tetovën, Vranjën, Qyprylinë, Shtipin, Koçanën etj., të gjithë këto qytete të shquara në Ballkanin Osman në zejen në fjalë.¹⁹

Zeja tjetër, ndoshta më e famshmja në sytë e evropianëve, tradicionale për viset shqiptare, duke përfshirë edhe Shkupin, ishte ajo e armëtarëve.²⁰ Deri në mesin e shek. XIX, ajo njohu një rritje të dukshme dhe mbulonte një përqindje të madhe të eksporteve nga trevat shqiptare edhe përtej rajonit të Ballkanit. Ndonëse në këtë zeje nuk arriti nivelet e

¹⁴ Jovan Haxhivasiljeviq, *Skoplje i njevoja okolina*, Beograd: 1930, f. 44.

¹⁵ Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f. 106.

¹⁶ S. Frashëri, *Kamus*, II, f. 927.

¹⁷ Georg Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: 1854, f. 132.

¹⁸ *Salname e vilajetit të Manastirit (1890)*, f. 201.

¹⁹ *Archives du Ministère des Affaires Etrangères de France* (më tej: *AMAEF*), Konsullata e Francës në Shkodër, rel. 18.09.1866, rel. 20.08.1863.

²⁰ *Salname e vilajetit të Manastirit (1885)*, f. 202.

Prizrenit, Tetovës, Gjakovës apo Shkodrës, Shkupi bënte pjesë ndër qendrat e rëndësishme të kohës për prodhimin e armëve.²¹

Argjendaria ishte një zeje tjetër e shquar për Shkupin. Cilësia e produkteve të Shkupit në këtë lëmë, sikurse konstatojnë nëpunësit e Perandorisë Osmane, nuk e arrinte atë të Prizrenit, që vlerësohej në mënyrë të veçantë, por gjithsesi, ishte mjaft e lartë.²²

Në periudhën e fundit të sundimit osman, në viset shqiptare doradorës ishin ngritur edhe një sërë ndërmarrjesh kapitaliste, ndonëse shumica e tyre ishte larg parametrave për t'u cilësuar të tilla. Më tepër ato kishin pamjen e punishteve të mëdha me disa makina e pajisje dhe punësonin disa dhjetëra vetë. Në dekadën e parë të shek.XX, numëroheshin rreth 40-50 ndërmarrje të tilla, nga të cilat 20 njësi janë regjistruar në Shkup. Shkodra, qyteti i dytë në viset shqiptare me më tepër fabrika, ku zhvillonin aktivitetin rreth 12-15 të tilla, duhej të pajtohej me faktin se Shkupi printe në viset shqiptare në krijimin e ndërmarrjeve të tipit të ri kapitalist. Humbja e Ulqinit dhe Tivarit të aneksuara nga Mali i Zi, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, kishin pasur një impakt të dukshëm negativ për Shkodrën, ndërkohë që ndërtimi i hekurudhës Selanik-Mitrovicë në vitet 1873-1874, i kishte dhënë qytetit mbi Vardar mundësi të reja për të fituar pozitën e një qendre kyç në rajonin e Ballkanit Qendror. Padyshim, Shkupi në këtë kohë filloi të merrte një rol parësor në kuadër të tregut kombëtar shqiptar, veçanërisht në regjionin Mitrovicë, Prishtinë, Ferizaj, Shkup, por edhe më gjerë, në rajonin ballkanik deri në Beograd, Budapest, Bukuresht, Selanik etj. Mallrat dhe kapitalet austro-hungareze, që vinin nga krahu i Shkodrës, dhe ato anglo-franceze, madje dhe italiane, që vinin nga Selaniku, në konkurrencë midis tyre për të zotëruar tregjet në Ballkan, ndikuan si një rast i mirë për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik të Shkupit.²³ Në Shkup, në dekadat e fundit të shek.XIX, bizneset kapitaliste u zhvilluan kryesisht në industrinë e blojës me motor të drithërave, përkatësisht mullinjve me motor, mandej në ndërtimin e fabrikave të birrës dhe të akullit, fabrikave të tekstilit, të duhanit, ndërmarrjeve grafike, atyre të përpunimit të lëkurës etj. Sipas të dhënave të kohës një pjesë e këtyre bizneseve, përkatësisht mullinjve të blojës, si edhe fabrika e birrës dhe e akullit, e krijuar më

²¹ *Po aty* (1898), f.202.

²² *Po aty* (1895), f. 203.

²³ *AMAEF*, Consulat de France a Scutari, Scutari, le 25 juillet; Shih edhe Z.Shkodra, *Qytetet...*, f. 253, 261, 263 etj.

1891, ishin tërësisht në pronësi të shqiptarëve, kurse të tjerat në pronësi të përzier ose në pronësi të elementëve bullgaro-maqedonas.²⁴

Vihet re qartë se Shkupi në dekadat e fundit të sundimit osman po orientohej me efikasitet drejt formave të reja të prodhimit e tregtimit, duke u përpjekur të gjallërojë, në kushtet e reja, lavdinë e së kaluarës. Bezistani i famshëm i shek.XVII, i cili nuk ekzistonte më në gjysmën e dytë të shek.XIX, (ai nuk figuron sipas Salnamesë të v.1887), ua kishte lënë vendin formave më moderne të tregtimit. Qyteti kishte tani rrjetin e magazinave e hambarëve për depozitim të mallrave të ndryshme, kishte zyra të tregtarëve të pasur, që mbulonin eksport-importin, të grupuara në zonën e stacionit hekurudhor etj.²⁵ Në një numër të këtyre magazinave depozitoheshin dhe produktet bujqësore të rrethinave të qytetit, të destinuara për tregun vendas dhe për eksport. Në *Enciklopedinë* e Sami Frashërit, në listën e prodhimeve në zë të viseve shqiptare, evidentohet për Shkupin, grosha e famshme, që me sa duket prodhohej në sasi të konsiderueshme në fushat përreth, por edhe më tej në Pollog²⁶. Tregu i Shkupit, në fund të shek. XIX, ofronte në sasi të konsiderueshme edhe lesh, prodhime të tij, lëkurë e prodhime lëkure, prodhime metalesh etj.

Infrastrukturën e tregut të Shkupit e plotësonte edhe një numër i madh hanesh, që shërbenin për akomodimin e udhëtarëve dhe tregtarëve të shumtë,²⁷ të cilat në periudhën e fundit të sundimit osman filluan të konkurrohen nga hotelet, që ofronin shërbime sipas parametrave evropianë. Pjesë e kësaj infrastrukture të rinovuar u bënë edhe restorantet, zyrat postare, telegrafet, lulishtet dhe shëtitoret publike etj. Qysh në vitin 1866, filli telegrafik lidhte Shkupin me Prizrenin, Pejën, Nishin, Shkodrën dhe vise të tjera të Perandorisë Osmane²⁸.

Është për të vënë në dukje se, në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe të konsolidimit të tregut kombëtar shqiptar në trevat shqiptare, mori përhapje masive edhe përdorimi i gjuhës së shkruar shqipe (me alfabet të ndryshuar, kryesisht me gërma latine) në marrëdhëniet e biznesit. Kjo dukuri me rëndësi të madhe shoqërore e karakter kombëtar, e çuar

²⁴ *Salname e vilajetit të Manastirit (1897)*, f. 20; Shih edhe D.Zografski, *Razvitak na kapitalistiçkite elementi vo Makedonija za vreme na turskovo vladenje*, Skopje: 1967.

²⁵ J. Müller, *Albanien...*, f. 62.

²⁶ S. Frashëri, *Kamus ...*, shih *Shkupi*, vëll.II, f. 928.

²⁷ Ami Boué, *La Turquie d'Europe*, Paris, 1840, vëll. III, f. 246-247.

²⁸ Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f. 421; *AMAEF*, G. Viet, Rel. 18, viti 1866.

përpara veçanërisht nga sipërmarrësit e sferës së tregtisë, zuri fill që në shek.XVIII por, sipas të dhënave arkivore, në shek. XIX, ishte bërë masive dhe ndeshej jo vetëm në trevat shqiptare qendrore por edhe në kufijtë skajorë të trevave shqiptare, përkatësisht nga Tivari e Ulqini, duke përfshirë Podgoricën, mandej, të gjithë qendrat kryesore të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës, deri në Shkup²⁹.

Është e qartë se Shkupi në periudhën e fundit të sundimit osman ishte përfshirë në rrjetin e lidhjeve solide tregtare me viset e tjera shqiptare, që mundësuan krijimin e një bashkësie ekonomike të mbështetur mbi një taban etnik shoqëror, politik e kulturor të përbashkët, në krye të së cilës, me sa duket, rrezatonte gjithnjë Shkodra. Tregtarët shkodranë mbanin lidhje të forta me ata të Prizrenit, Gjakovës e Shkupit, madje kishin krijuar magazina në këto qytete etj., deri në Manastir, ndonëse prania e tyre në qendrat evropiane si Venediku, Triestja etj., ishte pakësuar disa herë krahasuar me fundin e shek.XVIII³⁰. Por, falë pozicionit gjeografik, rritja e Shkupit si një qendër e madhe e botës shqiptare, ishte e dukshme dhe sfiduese. Në pozicionin e përshtatshëm midis dy krahinave shqiptare shumë të rëndësishme në planin ekonomik, Kosovës dhe Pollogut shqiptarët e Shkupit po luanin një rol të dorës së parë në zhvillimin ekonomik të qytetit, çka reflektohej edhe në përbërjen etnike të tij.

Zhvillimi ekonomik, padyshim, ishte shkaku që solli gjatë shek.XIX, rritjen e popullsisë së Shkupit. Rritja e shpejtë e qytetit dhe përbërja etnike e tij, që ruajti raportet e mëparshme, u pasqyrua edhe në urbanistikë. Ndonëse në tërësi qyteti kishte tiparet e qyteteve të Ballkanit Osman, në Shkup jo vetëm te bullgaro-maqedonët, por edhe te shqiptarët, vëreheshin banesa të ngjeshura pas njëra-tjetrës, pa hapësira të lira nga të gjitha anët, sikurse ndërtoheshin banesat e shqiptarëve në qendra të tjera urbane³¹. Kjo ishte pasojë e dukshme e intensitetit të jetës urbane të qytetit. Ndërkohë, banesat fshatare në rrethinën e Shkupit, të tipit kullë,

²⁹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi i veçantë i korrespondencës tregtare të firmës “Vllazën Çoba – Bianki”, shih edhe *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1968, f. 128. E. Çoba letër drejtuar St. Biankut, Shkodër, 1 shtator 1878; etj.

³⁰ Theodor Ippen, *Skutari und die Nordalbanische hustenebene*, Sarajevo: 1907, f. 29; A. Boué, *La Turquie ...*, f. 117-118.

³¹ S. Tomoski, *Makedonska narodna arkitektura*, Skopje: 1960, f. 43; Shih edhe Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f. 353.

me hapësira të bollshme përreth, me origjinë nga periudha osmane, vijuan të ndërtohen deri në vitet e Luftës së Parë Botërore³².

Shekulli XX e gjeti Shkupin një qytet me shumicë të padiskutueshme shqiptare, qendër e një treve rurale kryesisht shqiptare dhe një ndër qytetet më të mëdha të Ballkanit.

Sipas prof. Kristaq Priftit, që ka studiuar posaçërisht situatën demografike në trevat shqiptare në periudhën e fundit të sundimit osman, në vitet 1902-1904, Shkupi kishte 33.456 banorë, nga të cilët 20.667 ose 61.77% ishin shqiptarë (350 katolikë), 9.000 ishin bullgaro-maqedonë, ose 26,47%, 825 serbë (2.46%), 444 romë (1.3%), 1300 hebrenj (3.9%) dhe 1220 vllahë (3.64%). Kurse si kaza, rrethinat e Shkupit kishin edhe 155 katunde e 10.300 shtëpi. Popullsia e kazasë në tërësi arrinte kështu në 87.117 banorë, nga të cilët 49.112 ose 56.37% ishin shqiptarë (3205 katolikë), 25765 ose 29.53 % bullgaro-maqedonë (23265 ekzarkistë dhe 2500 pomakë), 8015 (9,28%) serbë, 1705 (2%) romë, 1300 (1,5%) hebrenj. Është për t'u theksuar se popullsia qytetare zinte 39% të popullsisë së kazasë.³³

Gati një dekadë më vonë qyteti i Shkupit numëronte rreth 45.000 banorë gjithsej, nga të cilët rreth 25.000 myslimanë (që përgjithësisht ishin shqiptarë). Këto të dhëna, që i kemi përmendur në fillim të këtij shkrimi janë të Gabriel Louis Jareyt (1913)³⁴, ndihmojnë për të përcaktuar strukturën e popullsisë së kazasë së Shkupit me konkluzionet në të cilat ka arritur edhe prof.dr. Ramiz Abdyli. Ai thekson se më 1912, kazaja e Shkupit në 65,33% banohej nga popullsi myslimane, kryesisht shqiptare, kurse popullsia bullgaro-maqedone zinte 32,24 % të popullsisë dhe ajo serbe vetëm 10,34 %. Sipas tij romët kishin 0,6% dhe hebrenjtë 1,59%.³⁵

Periudha postosmane, do të sillte pasoja të llojllojshme, që ndikuan në situatën demografike të Shkupit. Ai kaloi në disa duar pushtuesish në vitet 1912-1944. Ushtritë serbe e bullgare dhe një sundim 22 vjeçar i Mbretërisë Jugosllave, në periudhën midis Dy Luftërave Botërore, lanë gjurmë të ndryshme, por në të gjitha rastet ata që pësuan, në mënyrë

³² Z. Shkodra, *Qyteti ...*, f.368.

³³ Kristaq Prifti, "Popullsia e kazasë së Shkupit sipas burimeve arkivore të viteve 1902-1904", në *Studime albanologjike*, nr. 2, Shkup: 2010, f. 49-59.

³⁴ George Luis Jaray, *L'Albanie inconnue*, Paris: 1913, f. 9.

³⁵ Ramiz Abdyli, "Qëmtime mbi shqiptarësinë e Shkupit gjatë pushtimit osman", revista *Kosova*, Prishtinë, 2006, f. 28, 29, 30.

permanente e më së shumti, ishin shqiptarët. Gjithsesi ata do të mbeten popullsia shumicë. Edhe statistikat zyrtare jugosllave të publikuara mbi bazën e regjistrimit shumë të manipuluar të vitit 1921, madje në një kohë kur prej gati 10 vjetësh asgjësimi ose largimi i shqiptarëve kishte qenë masiv (1912-1921), dëshmojnë praninë e madhe të shqiptarëve në këtë qytet dhe në periferinë e tij. Sipas tyre, Shkupi kishte në këtë kohë 38.023 banorë, nga të cilët 15.713 shqiptarë myslimanë dhe 22.310 të krishterë të ndryshëm, kurse si rreth, ndër 54.089 banorë 24.299 vlerësoheshin shqiptarë myslimanë (18.032 shqiptarofonë), kurse 29.790 të krishterë të ndryshëm.³⁶

Sipas statistikave zyrtare, në vitin 1936, popullsia e qytetit të Shkupit përbëhej nga 66.893 banorë, prej të cilëve 42.664 ortodoksë, 22.951 myslimanë, 1873 katolikë dhe 3302 hebrenj. Ndër ortodoksët rreth 30.000 konsideroheshin serbë të ardhur³⁷. Sipas regjistrimit të bërë nga komuniteti mysliman (Uema Mexhllisit) i Shkupit, në vitin 1939, për gjithë popullsinë myslimane në Jugosllavi, që nuk ka qenë pa mangësi, të dhënat e të cilit u botuan në Sarajevo në kalendarin e vitit 1941, rrethi i Shkupit rezultonte, ndër rreth 134.400 banorë, me 57.791 myslimanë kryesisht shqiptarë, çka përbënte 43% të popullsisë.³⁸

Sikurse vërehet lehtë nga krahasimi i shifrave politika specifike e Mbretërisë Jugosllave e kishte bërë të vetën. Me infiltrimin në qytet të serbëve të ardhur në periudhën midis Dy Luftërave Botërore (një pjesë si nëpunës, ushtarakë, punëtorë, kolonë etj.), vetëm deri më 1925 në rrethin e Shkupit ishin ngritur 22 koloni³⁹). Së bashku me të ardhurit, elementi sllav i marrë në tërësi e kaloi numrin e shqiptarëve, ndonëse edhe në këtë kohë po të llogaritej vetëm popullsia sllave vendase, shqiptarët vazhdonin të kishin gjithnjë shumicën absolute⁴⁰.

Situata pati një ndryshim afatshkurtër në vitet 1941-1944, kur serbët e ardhur u larguan nga Shkupi dhe, sipas H. Kokalarit, diplomat shqiptar i

³⁶ H. Kokalari, *Kosova ...*, f. 93, 97.

³⁷ Hamit Kokalari, *Kosovo, berceau du peuple albanais et foyer de sa renaissance nationale*, Tirana: 1943, f. 229.

³⁸ *Po aty*, botim i vitit 1962, f. 95.

³⁹ Gjorgje Kërstiq, *Kolonizacija Jushnoj Srbiji*, Sarajevo: 1928, f. 40. Disa nga kolonitë ishin Ognjanci (serbë), Rzhaniçani (serbë), Dushnovac (hercegovinas), Lisica e Sipërme (të ndryshëm), Hasanbeh (serbe). Sipas Gj. Krstiqit qysh më 1928 kolonizimi e kish dyfishuar popullsinë e Shkupit, duke u bërë qendra kryesore e “Serbisë Jugore”.

⁴⁰ H. Kokalari, *Kosova ...*, f. 99.

njohur, rezident në përfaqësinë e Shqipërisë në Shkup, qyteti më 1943 kishte 51.000 banorë, nga të cilët 29.000 shqiptarë, 15.000 sllavë maqedonë, 1.000 torbeshë, sipas tij shqiptarë myslimanë të sllavizuar, 1.500 arumunë, 500 grekë, 1.000 serbë e malazezë, 1.000 sllovenë e kroatë, 1.500 ciganë dhe 500 të tjerë, turq, gjermanë etj., çka do të thotë se shqiptarët për pak kohë, edhe njëherë do të përbënin rreth 65% të popullsisë⁴¹. Në të njëjtën kohë në fshatrat e periferisë, sipas ndarjes politike të kohës, jetonin 45.000 banorë, nga të cilët rreth 80% shqiptarë. Nga rreth 90 fshatra vetëm 3 ishin turke, 10 serbe, 14 bullgaro-maqedone, kurse koloni e ngulime të krijuara midis Dy Luftërave ishin rreth 45.⁴²

Por situata do të ndryshonte sërish pas vitit 1945, madje dukshëm në dëm të shqiptarëve. Popullsia e vjetër shqiptare e Shkupit, në një hark kohor rreth 100 vjeçar, që vjen deri në ditët tona, pothuajse u zhduk. Qendër për administratën e shpronësimit agrar të shqiptarëve dhe për grumbullimin dhe deportimin e tyre në Anadoll, qoftë në vitet e Mbretërisë Jugosllave, qoftë në Federatën Socialiste të Titos, Shkupi mbeti pa hapësira për shkupjanët e vjetër shqiptarë. Gjithsesi nga popullsia shqiptare rurale e grumbulluar për t'u shpërngulur dhe nga të ardhurit sporadikë prej periferive të afërta apo të largëta, qyteti e ruajti disi fytyrën shqiptare⁴³.

Në gjysmën e dytë të shek.XX., elita politike e Republikës së Maqedonisë, e krijuar rishtas në kuadër të RSFJ, me një politikë specifike shumëplanëshe, të miratuar në kryeqytetin federativ Beograd, arriti të përmbysë raportet dhe t'u sigurojë bullgaro-maqedonasve, të quajtur përfundimisht maqedonë, dominim numerik në Shkup, që me këtë rast ishte bërë kryeqytet i Republikës së Maqedonisë.⁴⁴ Në Shkupin e kësaj periudhe, shqiptarët nuk ishin më as politikisht as ekonomikisht dhe ishin fundosur plotësisht në fushat e arsimit e të kulturës.

Sipas regjistrimeve zyrtare të Republikës së Maqedonisë, popullsia në rrethin e Shkupit u rrit nga 172.146 banorë në vitin 1948 në 213.586 në vitin 1953. Ndërkohë popullsia shqiptare ra nga 35.635 banorë në 23.696 banorë, ajo maqedone u rrit nga 95.211 në 115 846 banorë, popullsia turke u rrit nga 15.717 në 44.645 banorë, kurse komitetet e tjera etnike

⁴¹ H. Kokalari, *Kosova ...*, f. 99, 229.

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ Shih Qerim Lita, "Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959)", *Studime Albanologjike*, nr. 1, Shkup: 2009, f. 75-105.


shkuan nga 24583 në 29.399 banorë. Përsa i përket komunës apo qytetit të Shkupit, situata evoluoi me një rritje të popullsisë nga 96.051 në 129.631 banorë. Në këtë kuadër maqedonët u shtuan nga 56.329 në 74.411 banorë, shqiptarët u pakësuan si asnjëherë (edhe si pasojë e pakësimit fiktiv nga konvertimi në turq) nga 7.861 në 3.884 banorë, turqit u shtuan nga 14.092 në 25.173 banorë, kurse grupet e tjera etnike nga 17.769 në 22.163 banorë.⁴⁵ Duke cituar burime autentike, studiuesi Qerim Lita shënon se vetëm në vitin 1954 dhe vetëm nga qyteti i Shkupit ishin shpërngulur 872 familje me 4.364 anëtarë, çka përfaqësonte 70% të numrit të familjeve dhe 68,61% të numrit të shpërngulurve nga Maqedonia. Rreth 500 familje të tjera me 2220 anëtarë parashikohej të shpërnguleshin në vitin 1955. Më 1956 u shpërngulën edhe 19.210 persona, shumica shqiptarë, por që në regjistra figuronin 13.970 turq, 2.228 shqiptarë, 2.106 pomakë, 151 të tjerë.⁴⁶ Llogaritur për gjithë periudhën nga viti 1951 deri në 15 mars 1959, nga Maqedonia u shpërngulën 143.800 banorë (11% e popullsisë së Republikës), të cilët në një masë të madhe, mbi 100.000, ishin shqiptarë dhe, në kuadër të këtij komuniteti, një përqindje e madhe e tyre ishin larguar nga Shkupi.⁴⁷

Shpërnguljet masive të shqiptarëve nga Shkupi e rajoni përreth nuk do të ndaleshin deri në vitin 1966, kur, pas Plenumit të Brioneve dhe goditjes së ministrit të Punëve të Brendshme të RFSJ, Aleksandër Rankoviç, u vu re një politikë më tolerante ndaj shqiptarëve. Megjithatë në mënyra nga më të ndryshmet, përfshi edhe emigrimin “për punë” në botën e jashtme, reduktimi i popullsisë shqiptare nuk u ndal. Zhvillimet e 20 vjetëve të fundit, pas shpërbërjes së RSFJ dhe pavarësimit të Republikës Federative të Maqedonisë, përbëjnë një kapitull më vete, po kjo periudhë nuk është objekt i këtij artikulli.

⁴⁵ Po aty; shih gjerësisht: *Arkivi i Maqedonisë*, Fondi 1, 42, 72, 1/1-67.

⁴⁶ *Po aty*, f. 97, 98.

⁴⁷ *Po aty*, f. 102-103.



VILLAGES DU DISTRICT D'USKUB

I) VILLAGES ALBANAIS. — Ce sont en général d'anciens gros villages, comprenant une population qui souvent dépasse les 500 et même les 1.000 habitants. La plupart de ces villages ont une population 100% albanaise musulmane. Quelques uns de ces villages abritent aussi un petit nombre de serbes ou macédoniens.

Nom du village:	Albanais:	Mosquées:	Serbes:	Macédoniens:
1) Vrezhalca	800	1	—	—
2) Tishovica	300	1	—	—
3) Dobrina	800	1	—	—
4) Smesnica	300	1	—	—
5) Strahojadica	150	1	—	—
6) Paligrad	800	1	—	—
7) Aldinca	350	1	—	—
8) Cervenavoda	250	1	—	—
9) Ram. Gaber	350	1	—	—
10) Vrtekica	630	1	—	—
11) Studenican	1.600	2	—	—
12) Gornji Koliçan	900	1	—	—
13) Dolnji Koliçan	750	1	—	—
14) Pagarusha (Torbeches)	400	1	—	—
15) Gomaleva (Idem)	400	1	—	—
16) Svetovo (Idem)	900	1	—	—
17) Humovo (Idem)	650	1	—	—
18) Elovo (Idem)	800	1	—	—
19) Drznilovo (Idem)	700	1	—	—
20) Malçishta	200	1	—	—
21) Draçevica	700	1	—	—
22) Morana	600	1	—	100
23) Crnivrh	550	1	—	—
24) Patishka	600	1	—	—
(et quelques Albanais orthodoxes)				
25) Jabolca	180	1	—	—
26) Sveta Petka	600	1	—	—
27) Barovo	380	1	—	300
28) Nerez	680	1	300	—

— 270 —

29) Krushopek	800	1	—	—
30) Gerçes	500	1	—	—
31) Shishevo	300	1	300	—
32) Matka	300	1	200	—
33) Gllumovo	500	1	—	—
34) Arnaki (Arnautkoy)	370	1	—	—
35) Çe'isna	410	1	—	—
36) Bukovik	590	1	—	—
37) Semenisha	380	1	—	—
38) Kopanica	1.350	1	—	—
39) Bojana	1.140	1	—	—
40) Rahçe	1.500	2	—	—
41) Gr. Sivilare	200	1	—	—
42) Dl. Sivilare	760	1	—	—
43) Nikishtan	1.400	1	—	—
44) Kondova	550	1	—	—
45) Gragan	400	1	—	—
46) Blaca	1.500	1	—	—
47) Starishefa	400	1	—	—
48) Breza	1.500	1	—	—
49) Ljuboten	1.054	1	—	100
50) Stracina	320	1	—	70
51) Mojanca	400	1	—	—
52) Orlanca	150	1	—	—
53) Grushina	500	1	—	—
54) Krusha	180	—	—	—
55) Batinca	300	1	—	—
56) Bara	—	—	—	—
57) Jazirca	—	—	—	—
58) Ciflik	—	—	—	—
59) Dejkovca	280	1	—	—
60) Radusha	810	1	—	—
61) Oresha	540	1	—	—
62) Nerashta	1.160	1	—	—
63) Jazhinca	560	1	—	—
64) Glloboçica	450	—	—	—
65) Odri	250	—	—	—
66) Perci	650	1	200	—
67) Dobrishti	1.280	2	—	250
68) Gloxha	300	1	—	300
69) Preshevi	880	1	—	—
70) Tearca	780	1	—	400
71) Slatine	1.150	1	—	—
72) Shimehevo	410	1	80	—

— 271 —

73) Otushishte	300	—	—	—
74) Zvorci	150	—	—	—
75) Kopanica	230	1	—	150
76) Grupçin	390	1	—	—
77) Doberca	600	1	—	—
78) Lerçe	740	1	—	—
79) Mecova	580	1	—	—
80) Novosela	240	1	—	—
81) Rogla	300	1	—	—
82) Cifliki	370	1	—	—
83) Laskarca	540	1	—	—
84) Rahovici	400	1	—	—
85) Kopagindol	320	1	—	—
86) Salarevo	660	1	—	—
87) Cerovo	330	1	—	—
88) Gurgurnica	650	1	—	—
89) Lukovica	—	—	—	—

N. B. — Les villages numérotés de 60 à 89 dépendaient autrefois de Tetova, tandis qu'actuellement ils sont rattachés à Uskub.

VILLAGES ALBANAIS ORTHODOXES SLAVISES:

90) Pusta Breznica	350
91) Gr. Solnje (Silna)	400
92) Dl. Solnje (Silna)	300

II) VILLAGES TURCS. — Dans le secteur oriental des environs d'Uskub, se trouvent aussi les villages turcs Konjare e Epër et Konjare e Poshtër (ou Gureler), de 1.500 habitants environ, ainsi que le village Kojlice, comprenant 150 habitants, dont un certain nombre de Slaves macédoniens.

III) VILLAGES SERBES. — Ces villages sont concentrés dans une localité située sur le versant méridional de la montagne Karadag (Cragora) au Nord d'Uskub:

1) Kuçkovo	400 habitants
2) Kuçevishte	1.500 »
3) Çuçer	1.000 »
4) Banjani	500 »
5) Gornjani	250 »
6) Glluvo	500 »

— 272 —

7) Pabuzhda	500	»
8) Brodec	200	»
9) Mirkovca	600	»
10) Bulaçana	1.400	»

IV) VILLAGES MACEDONIENS. — Ces villages sont habités de Slaves macédoniens, qui généralement passent pour Bulgaro-macédoniens:

1) Lubneca	1.500	habitants
2) Raahatak	200	»
3) Sreshevo	400	»
4) Divle	600	»
5) Breznica	200	»
6) Lefterce	150	»
7) Kozhla	400	»
8) Dracevo	950	»
9) Goverlovo	350	»
10) Rakotica	200	»
11) Usinje	300	»
12) Sopishta	500	»
13) Sushica	300	»
14) Gradovci	300	»

V) COLONIES OU HAMEAUX CRES PAR LA COLONISATION YUGOSLAVE. — Les terres de ces colonies ou hameaux appartenant autrefois aux riches familles albanaises d'Uskub, et sous la domination yougoslave elles ont été colonisées avec des éléments serbes et slaves macédoniens. Leur population est composée partiellement d'Albanais, qui s'y trouvaient installés déjà à l'époque de la domination ottomane et qui, avec le temps, ont acquis leurs terres eux-mêmes. On ne peut évidemment pas les considérer comme colons, puisque la colonisation yougoslave a été appliquée uniquement au profit des éléments serbes et slaves macédoniens. Après l'effondrement du Royaume de Yougoslavie, les colons serbes et une partie des colons slaves macédoniens sont partis à destination de la Serbie, et leurs terres sont à la disposition des communes et de l'Etat bulgare qui les distribuent à d'autres colons macédoniens:

Nom du village:	Albanais:	Slaves macédoniens:
1) Ogjanca	50	150
2) Nahova	—	—
3) Idrizova	70	30
4) Urumler	60	100

— 273 —

5) Terbarova	70	70
6) Keremitiik	20	120
7) Stajkovsa	20	60
8) Brnarsa	20	140
9) Inçikova	80	50
10) Maçariik	70	200
11) Behlul Be	—	200
12) Ajvallı	—	100
13) Bunarçik	—	200
14) Biyikli	—	200
15) Kadi Koy	—	150
16) Emirhanlı	—	250
17) Ibrahim Koy	—	150
18) Iznisa	—	200
19) Kaplan (Kalkanovo)	—	200
20) Behadir (Bader)	—	60
21) Pakashovo	—	100
22) Tahor	—	250
23) Zelenikovo	50	80
24) Oroshan	50	100
25) Akbash (Gr. Lishice)	—	130
26) Doja (Dl. Lishice)	—	—
27) Ekshi Su (Kishevoda)	—	—
28) Gr. Vodna	—	120
29) Dl. Vodna	—	200
30) Tahtalija	—	40
31) Vlahi	25	50
32) Zlokuçan	—	70
33) Orizar	200	200
34) Novoselo	—	60
35) Bardofca	—	200
36) Vucidol	—	80
37) Orman	—	100
38) Radishana	30	60
39) Dobridol	—	200
40) Butel	—	60
41) Ljubosh	—	100
42) Hasanbeg	250	30
		(Albanais et 150 Bosniaques)
43) Araçina	150	100
44) Açarlar	50	200
45) Belimbeg	20	100

— 274 —

ZONE ALBANAISE DU DISTRICT DE KOUMANOVA

I) VILLAGES ALBANAIS:

Nom du village:	Albanais:	Mosquées:	Serbes:	Macédoniens:
1) Nikushtak	1.220	1	—	—
2) Ropales	510	1	—	—
3) Vlashtica	620	1	—	—
4) Mastejç	1.420	1	500	—
5) Hotla	1.230	1	—	—
6) Lipkova	1.280	1	—	—
7) Slupçan	1.010	1	—	—
8) Orizar	790	1	—	—
9) Vaksinca	1.080	1	—	—
10) Lojan	980	1	—	—
11) Sopot	240	1	100	—
12) Konjare e Madhe	160	1	100	—
13) Bahmani	740	1	—	400
14) Lopat	690	1	300	—
15) Opai	260	1	120	—
16) Strime	520	1	—	—
17) Harkofs	370	—	—	—
18) Gilazhan	420	1	—	—
19) Geshinca	670	1	—	—
20) Bellanofca	800	1	—	—
21) Zlakuçan	105	—	—	—
22) Strazhe	170	1	—	—
23) Rugince	730	1	—	—
24) Allashefs	605	1	—	—
25) Izvor	410	—	—	—
26) Gilega	200	—	—	—
27) Caushtkol	90	—	250	—
28) Cerkez	150	—	—	—
29) Studenabara	85	—	—	—
30) Tekékol	155	1	—	—
KUMANOVA (la ville)	5.000	1	5.000	5.000

II) VILLAGE SERBE: Tabanovca.

— 275 —

ZONE ALBANAISE DU DISTRICT DE PRECHEVA ET ZONE ALBANAISE DE LA BINACËA MORAVA

I) VILLAGES ALBANAIS DE PRECHEVA:

Nom du village:	Albanais:	Mosquées:	Colons serbes:	Vieux serbes:
1) Norça	460	1	65	—
2) Ternova	660	1	250	—
3) Miratovca	2.000	1	—	—
4) Kurbalija	360	—	—	—
5) Rahovica	2.010	1	50	—
6) Ilinsa	370	1	—	—
7) Bukurofca I	280	1	150	—
8) Bukurofca II	—	—	—	—
9) Gospunica (Gospudinea)	180	—	—	—
10) Gara	310	1	—	—
11) Bukufca (Bukovce)	100	—	—	—
12) Shoshaj (Shosheja)	240	—	20	—
13) Rainca	990	1	300	—
14) Cirmatisa (Crnodica)	650	1	75	—
15) Bergeveca	220	—	—	—
16) Gramada (les habitants albanais de ce village se sont expatriés)	—	—	165	—
17) Verhani	200	—	—	—
18) Dubrosini et Muhamed	650	1	—	—
19) Nasalça	810	1	40	—
20) Letovica	730	1	260	—
21) Osilari	150	—	—	500
22) Luçani	720	1	—	—
23) Kunçuli	1.000	1	—	—
24) Ternovci	5.400	1	—	—
25) Turija	150	1	—	—
26) Bushtrani	350	1	—	350
27) Bugarina	80	—	200	—
28) Golemidol	100	—	100	50
29) Lerani (Relian)	100	—	50	200
30) Biliçi	790	1	—	1.280
31) Negovca	200	1	—	—

— 276 —			
32) Samolisa (Somolica)	420	1	—
33) Kosharca Çiflik	—	—	—
34) Geri (Aligerci, Talinovca)	540	1	20
35) Çukarka	100	1	60 50
36) Strezuvs	290	1	50 250
37) Ezenica	900	1	—
38) Muhuvca (Mahuvac)	380	1	—
39) Kamabushi	350	—	—
40) Çar	300	—	—
41) Suharna	310	—	—
42) Novoselo	340	—	—
43) Gjurgjuvac	220	—	—
44) Rakuvs	—	—	—
PRECHEVA (ex-chef-lieu du district de même nom)	4.000	1	1.000
BILJANOVA (chef-lieu actuel du district de Precheva)	200	—	1.500
(et 1.000 Tsiganes musulmans)			
II) VILLAGES SERBES:			
1) Levosova	110	familles serbes	
2) Buzinovci	25	» »	
3) Barovca	38	» »	
4) Novoselo i Blaghi	70	» »	
5) Brodseica	40	» »	
III) VILLAGES ALBANAIS DE LA ZONE DE LA BINAČKA MORAVA:			
Nom du village:	Albanais:	Mosquées:	Colons serbes: Vieux serbes:
1) Drenogllava	240	—	—
2) Verban	360	1	—
3) Trestenik	250	1	—
4) Sodovina	—	—	—
5) Drobesh	70	—	—
6) Korbić	370	1	—
7) Debelde	270	—	—
8) Tanishes	400	—	—
9) Mijak	180	—	—
10) Sm'ra	760	1	—
11) Goshica	220	—	—

— 277 —			
12) Kabash	310	1	—
13) Germova	100	1	—
14) Godeni	380	—	—
15) Lubishta	770	1	—
16) Begunsa	640	—	—
17) Putgursi	60	—	—
18) Mogila	190	—	—
19) Gjylekari	740	1	120
20) Rimnik	640	1	300
Après les massacres effectués au mois de Mars 1942, par les militaires bulgares et les Serbes de la région contre les habitants albanais de ce village, ces derniers se sont expatriés pour se réfugier au Kossovo.			
21) Nasala	110	—	—
22) Ladova	160	—	—
23) Zheger	1.100	1	180
24) Lashica	600	1	—
25) Uglari	520	1	—
26) Pograca	910	1	—
27) Lofca	400	1	—
28) Ranatoveci	—	1	—
29) Kokaj	350	—	—
30) Slabisa	170	1	—
31) Mačera	185	—	—
32) Depasa	630	—	—
33) Muçibaba	380	1	—
34) Lipovica	210	—	—
35) Borinca	110	1	—
36) Buhici	140	—	—
37) Staneshi	285	—	—
38) Lezhbali	—	—	—
39) Grubali	150	—	—
40) Peçena	360	1	—
41) Caravajka	115	—	—
42) Stublina	230	1	—
43) Pidici	170	—	—
44) Celiki	340	—	—
45) Shurlani	430	1	—
46) Dunavi	950	1	—
47) Stancijli	—	—	—
48) Sefer (habité aussi par des albanais catholiques)	360	—	—

— 278 —			
49) Stubla (idem)	290	—	—
50) Vernavokola (idem)	200	—	—
51) Binca (idem)	—	—	—
52) Zarinca	990	1	—
53) Pribovca	320	—	—
IV) VILLAGES DE LA ZONE DE LA MORAVA HABITES PAR DES ALBANAIS CATHOLIQUES SLAVIQUES:			
1) Letnica	250	—	—
2) Vrnez	200	—	—
3) Shushari	500	—	—
V) VILLAGES SERBES DE LA ZONE DE LA MORAVA			
1) Vitina	—	—	—
2) Pasiari	135	familles	
3) Raniluki	108	»	
4) Gr. Kormian	80	»	
5) Dl. Kormian	120	»	
6) Domorovci	130	»	
7) Glogovci	50	»	
DISTRICT DE KATCHANIK			
Nom du village:	Albanais:	Mosquées:	Colons serbes ou monténégrins:
1) Stari Kačanik	370	1	150
2) Stagovo	560	—	—
3) Bičevce	600	—	—
4) Nika	190	—	—
5) Runjeva	190	—	—
6) Nikovec	150	—	150
7) Belograca (Belgradca)	670	1	150
8) Gerlica	200	—	—
9) Doganaj	320	1	—
10) Dura	240	—	—
11) Gabrica	160	—	—
12) Sopotnica (Soponica)	250	—	—


— 279 —			
13) Dubrova	320	—	—
14) Vata	450	—	—
15) Slatina	400	—	200
16) Reka	240	—	—
17) Elez (Elias)	90	—	—
18) Raka (Araka)	80	—	—
19) Ivaja	420	1	—
20) Kottina	510	1	—
21) Puštenik	550	1	—
22) Kovacevci (Kovadzhek)	370	—	—
23) Gare (Gaire)	240	—	—
24) Eop (Bob)	290	—	—
25) Strazha	160	1	—
26) Gorance	480	1	—
27) Rzhance	390	—	—
28) Krvenik	420	1	—
29) Sečishta	640	1	—
30) Dramnjak	360	—	—
31) Palivodenica	430	1	—
32) Dimce	180	—	—
33) Vrtoninica	100	—	100
34) KATCHANIK (Chef-lieu du district)	1.700	1	—
35) Brodi	650	1	—
36) Bajnica	140	—	—
37) Burniki	200	—	—
38) Gačka	550	—	200
39) Ižanci	350	—	—
40) Semaja	250	—	—
41) Firaja	800	1	—
42) Bitinja	450	—	—
43) Kashtanjeva	700	1	—
44) Vica	250	—	—
45) Globočica	450	—	—

N. B. — Les villages numérotés de 35 à 45 étaient inclus autrefois dans le district de Ferizai (Ourochevats).

— 280 —

**REPARTITION DE LA POPULATION ALBANAISE
DANS LE SECTEUR D'USKUB**

	Albanais:	<i>Proportion par rapport à la population totale:</i>
1) DISTRICT D'USKUB		
Ville d'Uskub	30.000	60%
Environs d'Uskub	45.000	80%
2) ZONE ALBANAISE DU DIS- TRICT DE KOUMANOVA	22.000	60%
Abstraction faite de la ville de Koumanova		90%
3) ZONE ALBANAISE DU DI- STRIC DE PRECHEVA	25.000	90%
ZONE DE LA MORAVA	15.000	80%
4) DISTRICT DE KATCHANIK, y compris les villages qui étaient inclus autrefois dans le district de Ferizai (Ouroche- vats)	20.000	98%
5) Villages albanais du district de Veles	5.000	
	<hr/> 162.000	



CARTE ETHNOGRAPHIQUE
DE
SHKUPI (ULUSHA, SKOPJE), (KRAJINA, KUMANOVA, PESHKOPJE)
par Hamit Nohari

●	Ville albanaise	▲	Ville macédonienne
○	Village albanais	▼	Village macédonien
⊕	Village albanais catholique	◊	Village turc
⊙	Village albanais catholique serbe	◆	Centre serbe-macédonien
□	Village albanais orthodoxe	•	Terrain ou propriété appartenant aux membres de familles albanaises de Shkupi (albanais, catholiques) par les serbes d'actuelle
△	Village bosnien (albanais musulmans serbes)	▲	Terrain habités par des serbes macédoniens et par des albanais
△	Village serbe	▲	Ligne de démarcation délimitant les territoires occupés par la Bulgarie

Les signes précédents sont dessinés approximativement en proportion du nombre des habitants indigènes de chaque localité. Parmi la population indigène de la ville de Shkupi (albanais) la majorité absolue appartient aux albanais, tandis que le reste de la population est composé de Serbes macédoniens, roumains, grecs, turcs, italiens.

ÉCHELLE 1 : 200 000

Tirane 1971

Fragment i harrës etnografike të H. Kokalarit

*S u m m a r y*SHKUP, AN IMPORTANT ALBANIAN CENTER
OF THE 19TH AND 20TH CENTURIES

Shkup was considered one of the main Albanian cities of the four Vilayets, namely, the vilayets of Shkodra, Kosova, Manastir and Janina, with a clear ethnic composition. This opinion was shared also by several European travelers and diplomats of the 19th century who in their works present significant maps, ethnographic documents and statistical data. In the Ottoman registers of the 19th century and the beginning of the 20th, but also in the official registration of the population in 1921 in Yugoslavia, Shkup is considered an ethnically Albanian region.

During the 19th century Shkup was one of the three or four biggest cities among the 31 urban centers in the Albanian territories. In 1861 the Austrian ambassador, Han, wrote that the city of Shkup had more than 20.000 inhabitants of which 13.000 Muslims, 7.000 Christians and 8.000 Jews, which means that at that time the Slav population, which generally speaking was Christian, made up less than 30% of the population.

In the beginning of the 20th century Shkup had undoubtedly a majority of Albanian population, was the urban center for the mainly Albanian rural surroundings, and was one of the largest Balkan cities. Between 1902 and 1904 Shkup had 33.456 inhabitants out of which 61.77% were Albanians. While in the surrounding areas there were 155 villages with 87.117 inhabitants, out of which, 56.37% were Albanians. Prof. Dr. Ramiz Abdyli highlights the fact that in 1912 the Albanian Muslim population in the region of Shkup composed 65.33% of the population.

During the interwar period the Slav element outnumbered the Albanian one. However, if it was taken under consideration only the native Slav population the Albanians still would have been in absolute majority.

Between 1941 and 1944 when the non native Serbs left Shkup, in the city there were 51.000 inhabitants, of which 29.000 Albanians, 15.000 Macedonian Slavs, 1.000 Torbesh, 1.500 Vlachs, 500 Greeks, 1.000 Serbs and Montenegrins, 1.000 Slovenes and Croats, 1.500 Gipsy and 500 Turks, Germans, etc. This means that even during this time, although for a short period, the Albanians made up 65% of the population. At the same time in the surrounding villages, according to the administrative division of the time, lived 45.000 inhabitants of which 80% were Albanians.

In the second half of the 20th century a special multifaceted policy designed in the federal capital city of Belgrade, succeeded in overturning these figures.

According the official registrations in the Republic of Macedonia, the population in the region of Shkup increased from 172.146 in 1948, to 213.586 inhabitants in 1953. Meanwhile, the Albanian population decreased from 35.635 to 23.696 inhabitants.

As for the city of Shkup, the population increased from 96.051 to 129.631 inhabitants. In this context, the Macedonian population increased from 56.329 to 74.411 inhabitants, while the Albanians decreased in an unprecedented way (influenced also by the false conversion to Turks) from 7.861 to 3.884 inhabitants, the Turks increased in number from 14.092 to 25.173 inhabitants, while the other ethnic groups from 17.769 to 22.163 inhabitants.

From 1951 to 15 March 1959 from Macedonia were displaced over 100.000 Albanians a large part of whom had been removed from the city of Shkup.